

“INFORMACION MBI KUSHTET DHE LISTA E ÇMIMEVE PËR PRODUKTET E KREDISË KONSUMATORE, NË FUQI PREJ DATËS 10.06.2025”

Qëllimi i dokumentit	Ky dokument përbën një prezantim të kushteve dhe çmimeve të kredisë konsumatore në IuteCredit.
Kontakte:	IuteCredit Albania SH.A. Rruga: Andon Zako Çajupi, Ndërtesa Nr. 3, Hyrja Nr. 2, Tiranë +355 44505060 info@iute.al www.iute.al
Qëllimi i kredisë:	Kreditë konsumatore në vlera të vogla synojnë të përmbushin nevojat personale të individëve për blerje produktesh, apo nevoja të tjera të tyre.
Normat e interesit	Norma e interesit - llogaritet si një përqindje vjetore mbi principalin e papaguar të huasë për çdo periudhë dhe të shprehur si norma vjetore e 360 ditëve të vitit dhe 30 ditëve të muajit. Kredia “Cash” Shuma: deri në 600,000 Lekë Norma e interesit: 0-52.52% Afati: 2 - 60 muaj Kredia në Partnerë – Kredi për blerje produktesh në pika të autorizuar Shuma: deri në 600,000 Lekë Norma e interesit: 0 - 43% Afati 4 - 48 muaj
Norma efektive e interesit (NEI)	Norma efektive e interesit NEI është totali i kostos së kredisë për klientin e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë. Kostoja totale e kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan për kredinë, sipas kushteve të marrëveshjes së kredisë.
Komisioni i angazhimit	Komisioni i Angazhimit është një komision i aplikuar nga Kredidhënësi dhe përfaqëson kostot që lidhen me miratimin dhe disbursimin e kredisë. Komisioni i Angazhimit është i pagueshëm në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Kredisë Specifike dhe do të mbahet nga Shuma e Kredisë. Nëse klienti ka paguar një komision angazhimi dhe po ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga kredia, klienti do ta kthejë shumën e kredisë duke zbritur komisionin e angazhimit. Për kredinë “Cash” - min. 2.5 % - max. 5 % mbi shumën e kredisë, bazuar në profilin e riskut të klientit ; Për kredinë “Në Partnerë “ - 0.
Komisioni i shtyrjes së datës së pagesës	Komisioni i shtyrjes së datës së pagesës, është komisioni që paguhet nga huamarrësi në rast pezullimi të detyrimeve të huamarrësit, me kërkesë të këtij të fundit për disa ditë, pa ndryshuar datën e pagesës në grafikun e pagesave. Komisioni është 1,500 Lekë për çdo shtyrje. Për çdo ditë shtyrje, nuk aplikohet penalitetet ditor për ditëvonesa por në rast se klienti nuk paguan brenda afatit të shtyrjes, atëherë në përfundim të këtij afati, i aplikohen penalitetet ditore të vonesës për të gjitha ditët e shtyrjes.

Lëvrime i kredisë	Kredia do të disbursohet e gjitha në llogarinë e pagesës së parasë elektronike të klientit, të hapur pranë IutePay SH.P.K. Më pas, klienti mund të transferojë fondet e kredisë nga llogaria e pagesës së parasë elektronike në llogarinë e tij bankare, të tërheqë cash (para në dorë) nëpërmjet ATM-ve të iute-s, agjentëve të cash-it ose partner të cash-it. Në rast të një kredie të aplikuar pranë një partneri, kredia do të disbursohet në llogarinë e pagesës së parasë elektronike të klientit dhe më pas do të transferohet në llogarinë e pagesës së parasë elektronike të partnerit, sipas udhëzimeve të dhëna nga klienti.
Shlyerja e kredisë	Shlyerja e kredisë nga klienti do të kryhet në përputhje me planin e pagesës që klienti do të dakordësojë në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë. Klienti mund të depozitojë fonde në llogarinë e pagesës së parasë elektronike nga llogaria e tij bankare, nëpërmjet agjentëve të cash-it falas, pa asnjë kosto shtesë, fonde të cilat më pas shërbejnë për pagesën e kështit të kredisë.
Tabela e llogaritjes së NEI	Për shumën e kredisë prej 300,000 lekë për afatin 60 muaj, me interes 29.83 % dhe komision angazhimi 9,000 lekë (3%), i cili paguhet në momentin e disbursimit të kredisë, NEI i kredisë është 36.39%. Shlyerja mujore do të jetë 9,675 lekë. Ekuacioni për llogaritjen e NEI si në vijim: $300,000 = 9,000 + 9,675 / ((1+i)^{1/12}) + 9,675 / ((1+i)^{2/12}) + 9,675 / ((1+i)^{3/12}) + \dots + 9,675 / ((1+i)^{60/12})$ <u>$i = 36.39\%$</u> i (NEI) – është norma efektive e interesit, e cila mund të llogaritet (nga algjebra ose nga një program kompjuteri) si më poshtë: $\sum_{K=1}^M K_k (1+i)^{-tk} = \sum_{I=1}^{m'} R_I (1+i)^{-ti}$ m - është numri total i kësteve të lëvrimit të kredisë, nëse lëvrime i kredisë bëhet me këste (drawdowns), të paguar nga kredidhënësi. k - është kësti i k-të i kredisë i lëvruar nga kredidhënësi (nëse lëvrime i kredisë bëhet me këste), kështu që $1 \leq k \leq m$. K_k - është vlera e kështit të kredisë (drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (të lëvruar) në periudhën k. tk - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të kështit të parë të kredisë (first drawdown) të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrime i kredisë bëhet me këste) dhe datës së çdo kësti pasues të kredisë të vënë në dispozicion të klientit, domethënë $t_1 = 0$. m' - është numri total i kësteve të paguara nga klienti për shlyerjen e kredisë dhe/ ose pagesave të shpenzimeve. l - është pagesa e l-të e kryer nga klienti për shlyerjen e kredisë ose pagesën e shpenzimeve. R_l - është vlera e kështit të shlyerjes ose pagesës së shpenzimeve nga klienti në periudhën l. 15 ti - është intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të një viti, ndërmjet datës së lëvrimit të kështit të parë të kredisë të vënë në dispozicion të klientit (nëse lëvrime i kredisë bëhet me këste) ose datës së lëvrimit të kredisë (në rast se lëvrime i kredisë bëhet i plotë) dhe datës së çdo kësti për shlyerje dhe/ose pagimi shpenzimesh vijuese që paguan klienti.
Komisioni i njoftimit të vonesës	Komisioni i njoftimit të Vonësës është kuota që paguhet nga kredimarrësi për të mbuluar shpenzimet administrative që bën kredidhënësi për të njoftuar kredimarrësin për pagesën e tij në vonesë, me anë të mjeteve të qëndrueshme të komunikimit, të tilla si: letër njoftuese (shpenzime administrative për përgatitjen dhe dërgimin e letrës si dhe njoftimet e tjera me anë të

	telefonatave) dhe SMS-ve (shpenzime administrative për përgatitjen dhe dërgimin e SMS-ve). Klientit i ngarkohet një komision për njoftimet e detyrimeve të vonuara të dërguara me SMS nga dita e dytë e vonuar në shumën prej 25 Lekë (njëzetë e pesë lekë) secili dhe komision për njoftimet me shkrim të dërguara si më poshtë: paralajmërimi i parë me shkrim 300 (treqind) Lekë, paralajmërimi me shkrim përpara përfundimit të kontratës së kredisë specifike 350 (treqind e pesëdhjetë) Lekë.
Kamatëvonesa ditore dhe penalteti në datën e mbylljes së kontratës	Huamarrësi është i detyruar t'i paguajë huadhënësit kamatëvonesën në rastin e pagesave të kësteve që kryhen pasi ju ka kaluar afati (pagesa në vonesë) në shlyerjen e detyrimeve. Kamatëvonesa do të jetë 3% (tre për qind) në ditë e llogaritur mbi shumën e principalit plus interesin e çdo kësti në vonesë, duke nisur nga e nesërmja e datës kur detyrimi është bërë i kërkueshëm. Kamatëvonesat e parashikuara të cilat paguhën nga kredimarrësi, nuk tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/ kësteve të papaguar të kredisë). Zbatimi i kamatëvonesës nuk cenon të drejtën e huadhënësit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm apo për të zgjidhur kontratën në përputhje me parashikimet e saj. Penalteti në datën e mbylljes së kontratës është 30% e principalit e të gjithë kësteve të ardhshme duke nisur nga data e mbylljes së kontratës.
E drejta e tërheqjes nga kredia konsumatore	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredisë për një periudhë 14 ditore nga data e nënshkrimit të kontratës. Në rast se Klienti ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike, ai do t'i kthejë Kredidhënësit shumën e kredisë dhe interesin e perlllogaritur i cili llogaritet në bazë të ditëve që Kredia ka qenë në përdorim nga Klienti brenda të njëjtit afat prej 14 ditësh, duke zbritur vlerën e paguar të Komisionit të Angazhimit. Interesi llogaritet në bazë të normës së interesit në ditë siç është rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike.
Shlyerje përpara përfundimit të afatit të kredisë	Nëse klienti e mbyll vlerën e mbetur të kredisë përpara kohe, falet 100% i interesit të mbetur për muajt pasardhës. Në rast të shlyerjes së plotë të kredisë « Cash » përpara përfundimit të afatit, do të aplikohet komisioni i shlyerjes në masën 1 për qind të kredisë së parapaguar, kur periudha e mbetur e Kontratës së Kredisë Specifike është më e gjatë se 12 muaj dhe në masën 0.5 për qind të kredisë së parapaguar kur periudha e mbetur e Kontratës së Kredisë Specifike është më pak se 12 muaj. Në rast të shlyerjes së plotë të kredisë « Në Partner » përpara përfundimit të afatit, komisioni i shlyerjes është 0 Lekë.
Komisione për lëshim vërtetimesh/ dokumentacioni	Vërtetim u mbylljes së kredisë 2,000 Lekë; Vërtetim i balancës së kredisë: 0 Lekë nga aplikacioni Myiute dhe 2,500 Lekë e printuar; Kopje e kontratës së kredisë: 0 Lekë nga aplikacioni Myiute dhe 2,000 Lekë e printuar; Kopje e planit të pagesave (<i>installment table</i>) – 0 Lekë Ndryshim i kolateralit për kreditë e makinave – 2,000 Lekë; Bllokim i kolateralit (mjet motorrik) në RBS – 1,600 Lekë; Zhblokim i kolateralit në RBS – 2,000 Lekë.